



# KONTROLLI DHE MBIKËQYRJA POLITIKE E KUVENDIT MBI QEVERINË DHE MBI BARTËSIT E TJERË TË FUNKSIONEVE PUBLIKE

Kontrolli dhe mbikëqyrja politike mbi Qeverinë dhe mbi bartësit e tjerë të funksioneve publike që janë përgjegjës para Kuvendit është një ndër kompetencat e përcaktuara me Kushtetutën e Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Mekanizmat më të rëndësishëm për kryerjen e funksionit kontrollues dhe mbikëqyrës të Kuvendit janë këto: pyetjet e deputetëve, interpelanca, komisionet anketuese, mocioni i besimit të Qeverisë dhe debatet mbikëqyrëse.

## PYETJET E DEPUTETËVE

Secili deputet ka të drejtë që Kryetari të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, anëtarit të Qeverisë dhe bartësve tjerë të funksioneve publike të cilët janë përgjegjës para Kuvendit t'u shtrojë pyetje që ka të bëjë me punën e tyre ose me punën në kompetencë të tyre.

Pyetja mund të shtrohet gojarisht ose me shkrim. Pyetja me gojë shtrohet në seancë parlamentare, ndërsa pyetja me shkrim shtrohet nëpërmjet Kryetarit të Kuvendit në periudhën midis dy seancave.

Për të shtruar pyetjet e deputetëve në Kuvend konvokohet seancë e veçantë, çdo të enjte të fundit të muajit. Në seancë detyrimisht janë të pranishëm Kryetari dhe të gjithë anëtarët e Qeverisë. Në seancë janë të pranishëm edhe bartësit e funksioneve publike për të cilët është njoftuar se do t'u shtrohen pyetje. Nëse Kryetari i Qeverisë për arsye objektive ose arsye të pashtyeshme është e domosdoshme të largohet nga seanca, kjo mungesë nuk mund të jetë më shumë se një orë. Në një seancë deputeti mund të shtrojë maksimum tri pyetje. Shtrimi i pyetjeve të deputetëve nuk mund të zgjasë më shumë se dhjetë minuta, ndërsa deputeti ka të drejtë të

prononcohet nëse është i kënaqur me përgjigjen, por jo më gjatë se tri minuta. Përgjigja e pyetjes së shtruar gojarisht nuk mund të zgjasë më tepër se dhjetë minuta.

Renditjen e shtrimit të pyetjeve të deputetëve e përcakton Kryetari i Kuvendit në marrëveshje me koordinatoret e grupeve parlamentare, duke siguruar kështu proporcion dy ndaj një në favor të deputetëve të grupeve parlamentare të opozitës dhe të deputetëve të opozitës të cilët nuk janë të organizuar në grupe parlamentare.

Për shkak të përcaktimit të renditjes, deputetët e njoftojnë Kryetarin e Kuvendit për qëllimin që të shtrojnë pyetje deputetësh, edhe atë maksimum 24 orë para mbajtjes së seancës. Deputetët nuk e kanë për obligim të paralajmërojnë se kujt do t'ia shtrojnë pyetjen me gojë, përveç nëse pyetja ka të bëjë me bartësin e funksionit publik, që nuk është anëtar i Qeverisë. Në këtë rast, deputeti ka për detyrë të njoftojë se kujt ia shtron pyetjen e deputetit, që të mundet bartësi i funksionit publik të ftohet në seancën për shtrimin e pyetjeve të deputetëve.

Për pyetjen e shtruar gojarisht përgjigje jepet në seancën e Kuvendit, në të cilën është shtruar pyetja. Për pyetjet e

shtruar për Kryetarin e Qeverisë, përgjigje jep Kryetari ose përfaqësuesi i caktuar i Qeverisë, për pyetjen e shtruar për anëtarin e Qeverisë, përgjigje jep anëtarin e Qeverisë, ndërsa për pyetjen e shtruar për bartësin e funksionit publik, përgjigje jep bartësi i funksionit publik.

Me përjashtim, përgjigja mund të jepet edhe me shkrim, nëse për shkak të arsyeshme përfaqësuesi i Qeverisë, anëtarin e saj, ose bartësi i funksionit publik nuk është në gjendje të japë përgjigje me gojë. Përgjigja me shkrim jepet në afat prej njëzet ditësh. Përgjigja me shkrim i dorëzohet Kryetarit të Kuvendit, i cili menjëherë ia dërgon parashtruesit të kërkesës dhe të gjithë deputetëve. Në seancën e parë të ardhshme të parapare për shkrimin e pyetjeve të deputetëve, Kryetari e njofton Kuvendin për përgjigjen e dhënë.

Pas marrjes së përgjigjes, deputeti që ka shtruar pyetjen ka të drejtë të shtrojë pyetje plotësuese në kohëzgjatje prej tri minutash. Nëse përgjigja ka të bëjë me një pyetje që paraqet sekret, Qeveria, përkatësisht bartësi i funksionit publik mund të propozojë që përgjigja të jepet në seancën e Kuvendit pa prezencën e publikut. Për këtë propozim vendos Kuvendi me shumicën e dy të tretave të votave nga numri i përgjithshëm i deputetëve. Për pyetjet e deputetëve dhe përgjigjet nuk hapet diskutim, gjithashtu edhe përgjigja e pakënaqshme nuk bart ndonjë përgjegjësi, por publiciteti dhe përshtypja e lënë në publik i bën pyetjet e deputetëve mekanizëm të rëndësishëm të kontrollit. Praktika e transmetimit të seancave të Kuvendit në televizion është faktor, i cili i jep rëndësi shtesë këtij instituti.

## INTERPELANCA

Interpelanca për dallim nga pyetjet e deputetëve paraqet procedurë më të ndërlikuar dhe instrument të kontrollit politik mbi Qeverinë, ose mbi një bartës konkret të funksionit publik, rezultati i të cilit mund ta rrezikojë ekzistimin e Qeverisë dhe të shkaktojë humbjen e besimit në Qeveri. Edhe pse qëllimi i interpelancës nuk është përcaktimi i drejtpërdrejtë i përgjegjësisë politike individuale, por hapja e një diskutimi për çështje me interes më të gjerë për vendin, çështja e përgjegjësisë mund të vijojë, nëse pranohet interpelanca.

Interpelancë mund të iniciojnë minimum pesë deputetë në lidhje me punën e bartësit konkret të funksionit publik, Qeverisë dhe çdo anëtarin e saj veç e veç, si dhe në lidhje me çështjet e punës së organeve shtetërore.

Interpelanca me arsyetim parashtrohet vetëm me shkrim, e nënshkruar nga të gjithë deputetët që e parashtrojnë. Parashtrohet për Kryetarin e Kuvendit, i cili menjëherë e dorëzon tek ai për të cilin është dërguar. Subjekti i cilit i referohet interpelanca ka të drejtë të dorëzojë përgjigje me shkrim te Kryetari i Kuvendit maksimum 15 ditë nga dita e pranimit të interpelancës.

Ajo vihet në rendin e ditës në seancën e parë të ardhshme të Kuvendit, pas skadimit të 15 ditëve nga dita e dorëzimit të përgjigjes së deputetëve. Nëse përgjigja nuk dorëzohet në afatin e caktuar, interpelanca vihet në rendin e ditës në seancën e parë të ardhshme të Kuvendit. Deputetët mund ta tërheqin interpelancën vetëm para fillimit të debatit.

Të drejtën ta arsyetojë interpelancën në seancën e Kuvendit e ka njëri nga deputetët që e kanë parashtruar interpelancën, në kohëzgjatje prej 20 minutash. Subjekti i cilit i është parashtruar interpelanca ka të drejtë ta arsyetojë përgjigjen e tij me shkrim ose të japë përgjigje me gojë për interpelancën e parashtruar,

gjithashtu, në kohëzgjatje prej 20 minutash.

Debati për interpelancën zgjat një ditë pune deri sa të përfundojë lista e deputetëve të paraqitur për fjalë, me ç'rast paraqitja dhe rendi i deputetëve për të marrë pjesë në debat është e njëjtë me procedurën për të shtruar pyetje të deputetëve. Debati përfundon me votim që e shpreh (mos) kënaqësinë e Kuvendit me përgjigjen e marrë nga bartësi i funksionit publik ose Qeveria, maksimum deri në orën 24:00. Nëse Kuvendi e pranon interpelancën, miraton konkluzë në të cilën paraqitet qëndrimi në lidhje me konstatimet e interpelancës.

Mungesa e kënaqësisë së tillë nuk shkakton pasoja juridike për Qeverinë, ose për bartësin e funksionit publik, por mund të paraqet hyrje në ngritjen e procedurës për përgjegjësi politike, ose të rezultojë me dorëheqje të Qeverisë ose të bartësit të funksionit publik. Për shembull, nëse deputetët nuk janë të kënaqur nga arsyetimi i ministrit, për punën e të cilit është iniciuar interpelancë dhe pakënaqësinë e tillë e shprehin gjatë votimit, interpelanca mund të shkaktojë pasoja morale. Kjo do të thotë se ministri mund të japë dorëheqje, ose Kryetari i Qeverisë mund t'i propozojë Kuvendit shkarkimin e ministrit konkret. Kështu, sipas Rregullores së Punës së Kuvendit, debati ndërpritet nëse shtrohet pyetje për mocionin e besimit të Qeverisë, nëse Qeveria, përkatësisht bartësi i funksionit publik parashtron dorëheqje, ose nëse Kryetari i Qeverisë parashtron propozim për shkarkimin e anëtarit të Qeverisë, për punën e të cilit është parashtruar interpelanca.

Në historinë e dëritanishme të demokracisë parlamentare të Maqedonisë, si parashtrues të të gjitha interpelancave paraqitet opozita parlamentare.

## KOMISIONET ANKETUESE

Komisioni anketues është mekanizëm i cili mundëson ex-post kontroll mbi Qeverinë dhe mbi institucionet e tjera, të cilat për punën e vet përgjigjen para Kuvendit.

Komisioni anketues është trup i cili mund të themelohet me vendim të Kuvendit, me qëllim që të kryejë funksionin e kontrollit politik për të gjitha sferat dhe për çdo çështje me interes publik. Propozim për themelimin e komisionit anketues mund të parashtrorjnë minimum 20 deputetë. Përjashtim nga ky rregull paraqet Komisioni për Mbrojtjen e Lirive dhe të Drejtave të Qytetarit, që është Komision i Përhershëm Anketues.

Fushëveprimi dhe përbërja e komisioneve anketuese përcaktohet me vendimin për themelimin e tyre, me ç'rast kryetarët e komisioneve anketuese sipas rregullit janë nga radha e deputetëve të grupeve parlamentare të opozitës.

Komisionet anketuese themelohen me qëllim që të përcaktohen faktet dhe rrethanat në lidhje me çështjet kontroverze, për të cilat kompetentë janë ministritë dhe organet e tjera të pushtetit shtetëror. Komisioni anketues ka për detyrë të bëjë inspektim të dokumentacionit, të bëjë analizë të ndonjë ngjarjeje ose rasti të veçantë dhe këto konstatime t'i prezantojë para Kuvendit. Komisionet anketuese nuk mund të kenë funksione hetuese dhe funksione të tjera gjyqësore, por konstatimet e komisioneve anketuese mund të jenë bazë për ngritjen e procedurës për përcaktimin e përgjegjshmërisë të bartësve të funksioneve publike.

## MOCIONI I BESIMIT TË QEVERISË

Mocioni i besimit të Qeverisë paraqet instrumentin më të fuqishëm të Kuvendit për kontrollin e pushtetit ekzekutiv.

Mocionin e besimit të Qeverisë mund ta iniciojnë minimum 20

deputetë, në formë të shkruar dhe me arsyetim të shkaqeve. Kuvendi mund të votojë mocionin e besimit me shumicë votash nga numri i përgjithshëm i deputetëve (me shumicë absolute). Edhe pse procedura për parashtrimin e mocionit të besimit të Qeverisë është relativisht e lehtë, praktika tregon se shumë rrallë mund të votohet mocioni i besimit i Qeverisë. Në praktikën e deritanishme të parlamentarizmit të Maqedonisë, është votuar mosbesim vetëm për një Qeveri.

Mocion besimi mund të parashtrijë edhe Kryetari i Qeverisë në formë të shkruar ose gojarisht në seancën e Kuvendit.

Mocionin e besimit, Kryetari i Kuvendit menjëherë e dorëzon te deputetët, Qeveria dhe Kryetari i Republikës. Kur mocioni i besimit është parashtruar gojarisht në seancën e Kuvendit, Kryetari i Kuvendit për këtë e njofton Kryetarin e Republikës. Mocioni i besimit mund të tërhiqet deri para fillimit të seancës së Kuvendit, në të cilën diskutohet për mocionin e besimit të Qeverisë.

Për iniciimin e mocionit të besimit të Qeverisë, Kryetari i Kuvendit menjëherë konvokon seancë, e cila mbahet në ditën e tretë nga dita e iniciimit të mocionit të besimit të Qeverisë. Afati fillon të rrjedhë në ditën e ardhshme nga dita e iniciimit të mocionit të besimit të Qeverisë.

Për iniciimin e mocionit të besimit të Qeverisë mbahet debat. Të drejtën ta arsyetojë mocionin e besimit të Qeverisë e ka njëri nga deputetët të cilët e kanë parashtruar mocionin në kohëzgjatje prej 30 minutash. Renditja e deputetëve të cilët do të marrin pjesë në debat caktohet në marrëveshjen e Kryetarit të Kuvendit me koordinatorët e grupeve parlamentare para fillimit të seancës. Deputeti gjatë debatit mund të flasë më shumë herë në kohëzgjatje prej 15 minutash, ndërsa koordinatori i grupit parlamentar mund të flasë gjithsej 20 minuta.

Kuvendi e voton mocionin e besimit të Qeverisë pas përfundimit të ditës së tretë nga dita e parashtrimit të mocionit të besimit. Në rast kur mocionin e besimit të Qeverisë e parashtron Kryetari i Qeverisë gojarisht në seancë të Kuvendit, Kuvendi voton për mocion të besimit në seancën e njëjtë. Kryetari i Qeverisë ka të drejtë të mbajë fjalim në Kuvend para votimit të mocionit të besimit.

Nëse Qeverisë i votohet mocioni i besimit, Kryetari i Qeverisë në Kuvend e dorëzon dorëheqjen në afat prej 24 orësh nga votimi i mocionit të besimit. Për votimin e mocionit të besimit të Qeverisë dhe për dorëheqjen e dhënë, Kryetari i Kuvendit menjëherë e njofton Kryetarin e Republikës. Qeveria, të cilës i është votuar mocioni i besimit mbetet në funksion deri në zgjedhjen e Qeverisë së re. Mocion i sërishëm i besimit të Qeverisë nuk mund të parashtrohet para skadimit të 90 ditëve nga votimi i fundit i mocionit të besimit. Para këtij afati çështjen mund ta shtrojë vetëm shumica nga numri i përgjithshëm i deputetëve në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

## DEBATET MBIKËQYRËSE

Debatet mbikëqyrëse janë mekanizëm më i ri kontrollues, që për herë të parë është vendosur me Ligjin për Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, i miratuar në gusht 2009. Kështu, duke filluar nga janari i vitit 2010, në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut rregullisht mbahen debate mbikëqyrëse.

Debatet mbikëqyrëse mbahen që të merren informata dhe opinione profesionale në lidhje me përcaktimin dhe zbatimin e politikave, zbatimin e ligjeve dhe aktiviteteve të tjera të

Qeverisë dhe të organeve të administratës shtetërore.

Debatin mbikëqyrës e zbaton trupi punues amë i Kuvendit, në fushëveprimin e të cilit bën pjesë çështja që është lëndë e debatit mbikëqyrës.

Trupi punues amë në mbledhje mund të ftojë përfaqësues të Qeverisë ose të organeve të administratës shtetërore dhe të kërkojë prej tyre informata dhe shpjegime që janë lëndë e debatit mbikëqyrës. Në debatit mbikëqyrës mund të ftohen edhe persona të tjerë të cilët mund të japin informata për çështjet që janë lëndë e debatit.

Për mbajtjen e debatit mbikëqyrës, kryetari i trupit punues e njofton Kryetarin e Kuvendit, i cili pastaj me shkrim e njofton Qeverinë me kërkesë që të caktojë përfaqësues të autorizuar për çështjet të cilat janë lëndë e debatit mbikëqyrës. Pastaj, përfaqësuesit e autorizuar ftohen me shkrim në mbledhjen e trupit të punës në të cilën do të mbahet debati mbikëqyrës, nga ana e kryetarit të atij trupit. Ai mund të kërkojë nga përfaqësuesit e autorizuar që informatat, opinionet dhe qëndrimet t'i dorëzojnë edhe në formë të shkruar më së voni tri ditë para ditës së mbajtjes së mbledhjes së trupit.

Iniciativë për mbajtjen e debatit mbikëqyrës mund ta iniciojë një anëtar i trupit punues amë. Për mbajtjen e debatit mbikëqyrës, trupi punues vendos me shumicë votash nga numri i anëtarëve të pranishëm, e më së paku me një të tretën e numrit të përgjithshëm të anëtarëve. Në situatat

kur 15 deputetë në formë të shkruar kërkojnë mbajtjen e një debatit mbikëqyrës, kryetari i trupit punues është i obliguar që menjëherë të caktojë mbajtjen e tij. Rekomandim për mbajtjen e debateve të caktuara mbikëqyrëse te kryetari dhe anëtarët e trupit punues amë mund të japë Kryetari i Kuvendit me nënkryetarët dhe koordinatorët e grupeve parlamentare.

Gjatë debatit, anëtarët e trupit punues amë, por edhe deputetët, të cilët nuk janë anëtarë të trupit punues amë mund të shtrojnë pyetje për përfaqësuesit e autorizuar të Qeverisë, organet e administratës shtetërore dhe personat e tjerë të ftuar në debat, vetëm në lidhje me çështjen që është lëndë e debatit. Pas përfundimit të debatit mbikëqyrës trupi punues në Kuvend dorëzon raport në të cilin janë të shënuara esencat e fjalimeve, por gjithashtu mund të propozojë edhe konkluzione të cilat dorëzohen edhe në Qeverinë e Republikës së Maqedonisë së Veriut. Konkluzionet sipas rregullit publikohen në faqen e internetit të Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut.







- Çdo deputet ka të drejtë që Kryetarin të Qeverisë dhe bartësve tjerë të funksioneve publike të cilët janë përgjegjës para Kuvendit t'u shtrojë pyetje që kanë të bëjnë me punën e tyre ose me punën në kompetencë të tyre. Për të shtruar pyetje të deputetëve konvokohet seancë e veçantë e Kuvendit, të enjten e fundit të muajit.
- Minimum pesë deputetë mund të parashtrorjnë interpelancë në lidhje me punën e një bartësi konkret të funksionit publik, Qeverisë dhe çdo anëtar të saj, si dhe për punën e organeve shtetërore. Interpelanca vetvetiu nuk shkakton pasoja juridike për Qeverinë ose për bartësin e funksioneve publike, por mund të paraqesë hyrje në ngritjen e procedurës për përgjegjësinë e tyre politike ose të rezultojë me dorëheqjen e tyre.
- Kuvendi me vendim mund të themelojë komisione anketuese për të gjitha sferat dhe për çdo çështje me interes publik. Propozim për themelimin të komisionit anketues mund të parashtrorjnë minimum 20 deputetë.
- Kuvendi mund të votojë mocion të besimit të Qeverisë. Mocion të besimit të Qeverisë mund të parashtrorjnë minimum 20 deputetë, ndërsa vendimi për votimin e mocionit të besimit miratohet me shumicë absolute.
- Debatet mbikëqyrëse mbahen që të merren informata dhe opinione profesionale në lidhje me përcaktimin dhe zbatimin e politikave, zbatimin e ligjeve dhe aktiviteteve të tjera të Qeverisë dhe të organeve të administratës shtetërore.



ПРОГРАМА ЗА ПАРЛАМЕНТАРНА ПОДДРШКА  
PROGRAMI PËR MBËSHTETJE PARLAMENTARE  
PARLIAMENT SUPPORT PROGRAMME



Schweizerische Eidgenossenschaft  
Confédération suisse  
Confederazione Svizzera  
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development  
and Cooperation SDC

IMPLEMENTUAR NGA:



Ky publikim është përgatitur nga Instituti Parlamentar në kuadër të Programit për Mbështetje Parlamentare (PSP), i cili mbështetet nga Agjencia Zvicerane për zhvillim dhe bashkëpunim (SDC) përmes Ambasadës së Konfederatës Zvicerane në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

PSP zbatohet nga Instituti Kombëtar Demokratik (NDI), Instituti për Demokraci "Societas Civilis" - Shkup (IDSCS) dhe Qendra për menaxhimin e ndryshimeve (CMP). Përmajtja e publikimit në asnjë mënyrë nuk pasqyron pikëpamjet e SDC.